

8.111 - 1

PIRRO VISARI

PLESHTI  
ME FRE


Fabula



8/14-1  
V 74

Pirro Visari

Pleshti  
me fre  
fabula



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHERI»

*Redaktor*

PERIKLI JORGONI

*Piktor*

BARDHYL FICO



## **SHQIPONJA DHE URITHI**

Urithi shqiponjës i fliste njëherë:

— Si s't'u mërzit qelli, moj e mjerë!  
E vetme kë mbetur mbi botën pa anë,  
mërzitjen si shoqe ke vetëm pranë . . .  
Nën tokën e zezë, nën tokën e lumtur,  
kalon e rrjedhjeta siëndërr e bukur.

Seç klithi shqiponja dhe lart ngriti kokën:

— Kush tha, o urith, se unë s'dua tokën?  
Mbi tokën e shtrenjtë kam ngritur folenë  
dhe ajrit pareshtur gjithmonë shoh dhenë.  
Drejt diellit të zjarrtë sulem çdo ditë,  
përleshem pa frikë me shiun, stuhitë . . .  
Po ty, o i gjorë, të tremb kaltërsia,  
kur qiellin pushtojnë krahët e mia . . .

## DY TRENDAFILAT

Qëlloi njëherë që rastësisht  
dy trëndafila të rrinin bashkë.  
Njëri aromën hapte ëmbëlsisht,  
tjetri i bukur ish, por artificial.

Trëndafili i dytë i thotë të parit:  
— Besomë, vëlla, nuk ta kam zilinë.  
Ti vërtet i ke aromat e majit,  
por unë kam përjetësinë.

Ndërkohë një bletë mblodhi krahët  
dhe ulet mbi trëndafilin e parë.  
Më kënaqësi dhe etje i thithi nektarin  
dhe rishtas u sul një qellin e larë.

— Ç'vlen përjetësia jote, o trëndafil,  
dhe bukuria e zbehtë, artificiale?  
Ky çast ishte sa një përjetësi  
dhe kjo është përjetësi më e madhe . . .

Vërtet që petalet e mia një ditë  
dy vyshken, roniten në vjeshtën me erë,  
por vjeshta dhe dimri largohen sërishmi  
dhe gonxhe të reja do çel në pranverë ...

Kështu foli trëndafili me vesë  
dhe faqet iu skuqën akoma më shumë.  
Tjetri prej turpit u nxi dhe u zverdh  
dhe hështi i mekur, mbuluar me pluhur.



## **KORBI DHE FASHISTI**

Kur pa korbin majë pemës,  
një fashist që shkonte rrugës,  
ngriti pushkën, mori shenjë.  
Korbi klithi: prit, he burrë!

Nuk e di a ke dëgjuar.  
një proverb të qëmotit,  
një proverb të lëvduar:  
«S'ia nxjerr sytë korbi korbit!»

— Ashtu qoftë, — tha fashisti, —  
si dhe ti i zi unë jam.  
Por një plumb përdhe e shtriu,  
ishte plumbi partizan.

U sul korbi menjëherë,  
se gostinë shtruar gjeti.  
Krakaviti me poterë,  
drejt në mish e nguli sqepin.



Ende fryma pa i dalë  
tha fashisti disa fjalë:  
— Po proverbin e lëvduar  
shumë shpëjt e ke harruar.

— Si proverbi s'ka të dytë,  
i lëvduar e me mend.  
por proverbi flet për sytë  
dhe gjë tjetër nuk përmend.

Vërtet ishim aleatë  
sa qëndroje fort në këmbë,  
po kur bie s'jemi bashkë.  
Ti e di që mroj me kërmë.

## **FUNDI I PARAZITËVE**

Grera parazite  
vërtitej ditë e natë,  
pa bërë dyll e mjaltë,  
po duke ngrënë qyl  
në kurriz të bletës..

Një merimangë prej cergës,  
ia vuri synë  
dhe nisi të tjerrë fjalët:  
— Moj bukuroshe e rrallë,  
meskëputur si flutur!  
Eja shikoje përhurën time  
me xhixha si ru賓inë.  
Fundja ta kam falur, është jotja  
dhe bëj një fustan për mërak  
që të pëlcasë gjithë bota.

Grera torollake,  
hovi në rrjetë  
ku ngeci si peshk

Zukati e trishtuar,  
po merimanga e shpejtë  
punën e kish mbaruar  
«Fustani» i grerës  
gjithë shkëlqim,  
u bë menjëherë  
qefin.

## D E M A G O G J I

I thoshte një ditë ariu bletës:

— Më pëlqen se je punëtore me vlerë.  
E shoh se disa herë pa të drejtë  
në punët e tua kot jam përzier.

Ja ku po të betohem se që sot e tutje  
më nuk kam për të të ngacmuar,  
por dhe për ty e kam një lutje:  
s'ke ç'e do atë thumb të mallkuar!

Zhuzhuriti bleta duke tundur krahët.

— Nuk trazoj kërkënd pa më rënë në qafë,  
veç sa kohë llupës e makut do të ketë,  
thumbin do ta mbaj gjithmonë të mprehfë!




## LËVOZHGA KONSERVATORE

Brenda në vezë  
zogu po rritej.  
Lëvozhaga nga jashtë  
me zërin mjaltë  
i pëshpërisme:

— Zog, mos u bëj liberal!  
Brenda je mirë, për ideal!  
Jashtë bën ftohtë,  
era fryn si e marrë.

Dëgjomë mua ti!  
Çdo gjë me këta sy  
e kam parë.

Prit!  
Kur të dalë dielli dhe të hapen retë,  
të lajmëroj vëtë.



Zogu i shkretë,  
e dëgjoi lëvozhgën e pabesë  
dhe priti e priti  
derisa pritja e lodhi  
dhe ... ngordhi.

## M U S T A Q E T

— Shih, pa shih, babai  
sa ka shkuar lart!  
Mustaqet në majë,  
iu bënë një pash...

Kallinjtë e verdhë  
dy okë secili  
Që ta merrni vesh,  
unë jam i bëri!

Kështu tha me mburrje,  
një filiz nga brazda,  
i dobët, i fishkur,  
me rrënjet përjashta.

Uji që po rridhte  
aty afër, qeshi:  
— Yt atë, të rritej,  
shumë punë deshi.


Derdhi djersë bujku,  
çau thellë tokën;  
barërat i zhduku,  
ndaj e ngrite kokën.

Pra ti shtriji rrënjet,  
rëndë mos u mbaj!  
Mos na bëj mburojë,  
mustaqe babaj!

## PLESHTI ME FRE

Pleshtin e zunë poshtë jorganit  
tek po hidhej, përfshidhej si akrobat  
dhe thanë mos ndoshta ndryshonte zanatin,  
po ta mësonin mos pinte më gjak.

Përsipër e mori një goxha burrë,  
i ditur, me shkollë e mjaft egzigjent.  
Ky preu ca rripa të hollë lëkure,  
vendosi t'i bënte pleshtit një fre.



SEPARATE THE DRAFTS  
Por pleshti kërceu siç kishte zakon  
dhe natën i vajti njeriut në vesh.  
Trampën i futi, e hidhur pickoi:  
— Sido që të bëhem, unë jam plesht!

— S'ke faj, — tha njeriu, i zgjuar prej gjumit,  
— kur gjete të marrë, të ma bësh paq.  
Me sorollopin tënd nuk bëhet dot punë,  
veç thoji i mprehtë, ai të zgërlaq.



## **SËPATA DHE DRURËT**

Kërciste sëpata  
në pyllin me dru.  
Godiste atje,  
këpuste këtu.

Së fundi qëndroi  
tek druri i vjetër,  
i rrahur prej shqotës,  
i tharë prej erës.

I ra disa herë  
me forcë atij,  
kérceu përpjetë  
dhe tehu iu mpi...

Pa rrëth e rrotull  
dhe gjeti një tjetër,  
të njomë, të dobët,  
me gjethen e verdhë.

E çau në mes  
dhe bëri një pykë.  
Ia futi në gji  
drurit të dytë.



## *M B U R R J A*

Ish një gjeneral  
në kohët e vjetra,  
pinte, bëhej tapë,  
sa i kish kuleta.

Këndesi trimosh,  
rastisi një natë,  
kur po nxirrte zorrët,  
të kalonte pranë.



Si pa rrëth e rrrotull  
këndesi nuk priti:  
ç'nxori gjenerali,  
me etje çukiti.

Rakia e zuri  
dhe kaposhin shpejt:  
po ecte malumi,  
si varka në det.

E pa pula vëngër  
dhe iu çorr këndesit:  
— Qenke mbathur rëndë,  
sa s'të nxë qymizi . . .

— Hesht, moj, me të mirë,  
në mos shko në djall!  
Sonte kemi pirë,  
me një gjeneral.

## **TRIMËRI E RREME**

Në një dardhë hipën sipër  
të uritur dy udhëtarë.  
Një ari, një leshatar,  
erdhi poshtë që të hajë.

Tundi pemën gjithë forcë,  
kokrrat ranë breshëri.  
Kur ja, njëri s'u mbajt dot,  
mbi ariun ra ai.

Dhe ariu i tromaksur  
u largua si shigjetë.  
Foli shoku majë pemës:  
— Paskë qenë trim me fletë!

Gjegjet «trimi» i mërzitur:  
— Kush pandehu se po ik!  
S'munda dot ta çoja lidhur  
për në kopshtin zoologjik!



Ndesh në jetë dhe të tillë,  
historisë i venë vulë.  
Të rrëfejnë trimëritë  
që s'i kanë bërë kurrë.

## **PARA AGRESIONIT**

Ujku i stepave një ditë,  
veshi kostum e vuri kravatë,  
bleu këpucë lustrafin,  
teu türinjtë me ponadë.

Zërin përpunoi për mrekulli,  
Ja ulërimat dhe filloi këngët.  
E binte kitarës më ëmbëlsi  
dhe vjersha bënte për dhentë.

Mbi trungun e prerë të lisit,  
jepte koncerët filarmomie  
dhe që të tregonte se s'hante më mish,  
kafshonte ca bisqë hardhie.

Dy dele shushka, të humbura,  
diskutonin, atë duke e parë:  
— E sheh, dhe qimen ka ndërruar!  
Thonjtë i ka prerë, mban dhe kollaro!

## DISKURS

Ujku që shihte nga sipër prej skenës,  
priti t'i vinin dhe pak më afér,  
pastaj kérceu sa fundi dhëmë,  
flaku këpucët dhe kravatën.

Buçiti kitara përplasur në drurë,  
delet blegërinë me këmbët përpjetë.  
Ujku tha duke u rrjepur lëkurën:  
— Në fakt, ky është koncerti i vërtetë.

## K N E R I

Dhelpra, ujku e luani,  
dolën bashkë që tē hanë.  
Një këndes, një ka, një dash,  
ranë preh në këtë gjah.  
Dhe luani, kryetar,  
cakton ujkun pér tē ndarë.  
Ujku, dashin la pér vete  
dhe këndesin zonjës dhelpér.  
Dihet, kau pér luanin  
si më trimi e kapedani.  
Por luani i zemëruar,  
quan ndarjen tē nxituar.

Godet ujkun fort me putër,  
laradash e hedh më tutje  
dhe fton dhelprën që po dridhej:  
— Ndaje gjahun ti, moj mike!  
Dhelpra ndenji pak menduar,  
pastaj nisi pa nxituar:  
— Pér mëngjes, besoj, del dashi  
dhe pér drekë do kesh kaun.  
Ndaj tē ngrysur shikon si meze  
ky këndesi me një teke.

Ç'mbeten kocka e thërrime,  
hamë ne pa pretendime.

Flet luani i gëzuar:

— Kush të bëri kaq të zgjuar?

Qeshi dhelpra nëpër dhëmbë:

— Shoh atë që po tund këmbët.

## FUND I TURPSHËM

Nga ffakët i rrëthuar  
akrepi s'di ku vete  
dhe thumbin e helmuar,  
në qafë ia fut vetes.

## KESHILLE MIKROBORG PEZI

Vidha i thoshte dikur gozhëdës:  
— Siç ecën ti nuk eset jetës,  
se le që mund të thyesh kokën,  
por edhe shkuleshi shumë lehtë.

Me të përdredhun ngalem unë,  
në fillim dua veç pak vend.  
Pashaj, në thieb hëjmë një rrugë,  
veç rruga ime tregon mend.

## **SHOKËT E KEQIJ**

Mbi një derë të lyer  
ku shkëlqente boja,  
një mizë e rrëmbyer,  
u ul gjithë ojna.

Shkonte aty afër  
dhe një mizë tjetër  
é cila e pyeti:  
— Ç'bën aty, moj zemër?

Foli miza e derës:  
— Mos më pyet, moj mike,  
është kaq vend i bukur,  
sa nuk mund të iket.

Dihet përfundimi:  
Miza e gënjer,  
ndali fluturimin  
dhe mbeti mbërthyer.


SHALLOM M. MOYANO

Miza hileqare,  
bëri dhe shaka;  
— E keqja me shokë,  
përgjysmohet, — tha;

## **MONOLOGU I FILLIT**

Dridhet furka; dridhet,  
filli mbas tij mbolidhet.  
Ku është m'i hollë,  
të mbetet në dorët.

Ndryshe duket faji  
nga çdo gjë në jetë:  
Sa më tepër majmet,  
këputet më shpejt.




## P E R G J E G J E S I A

Këmbora i tha  
dashit me brirë:  
— Duhet qafë, vëlla!  
Nuk po më tund mirë.

## HIPUR MAJË GARDHIT

Hipur majë gardhit,  
këndonte këndesi.  
Nga mbrapa kurrizit  
e ndriçonte dielli.

Hija mbi tokë  
zgjatej për hata.  
Një gomar e pa,  
qeshi edhe tha:  
— Ç'kokë, mashalla!



## INTERVISTA E KORBIT

Korbin intervistuan  
lart, mbi një çati:

— A mund të na thuash  
ka më zi se ti?

— E madhe bota shumë,  
mban edhe truthorë.  
Më të zinj se unë  
janë ca kollovarë...

Për pakëz qytet,  
shesin dhe babanë.  
Hyjnë derr në thes  
në portën e parë.



## *MACJA DHE TIGRI*

Kur ish tigri në pushtet,  
rrotull vinin lajkatarët.  
Macja mburrej gjithë qejf:  
— Biem kushërinj të parë.

Po kur tigrin gjuetarët  
e mbërthyen pas një druri,  
macja nisi nga të sharat:  
— E kish trashur mjaft zullumin!

Mizorinë në gjak kish,  
qe makut e qe i prapë,  
ndonëse, për turpin tim,  
biem kushërinj të shtatë.



## **KË QËLLUAN SAÇMAT**

U përkulen zhukat me zhurmë tek këneta:  
një rossé njomëzake u përpëlit e shtrirë.  
E kishte fluturimin e parë e shkreta,  
por saçmat qëlluan pa pasur mëshirë.

E zhveshën nga pendët e bukura, të buta,  
lakuriq e lanë siç nuk e pat bërë nëna  
dhe eci me trena, kamionë e autobusë,  
për ta çuar tek miku i «hallevë të rënda».

Kur ja, papritur, që nga gazeta,  
rosa zgjati kokën dhe tha: — Çudi e rrallë!  
Bëra një udhëtim me qindra kilometra,  
që s'e pata bërë dot sa isha gjallë.

Kur të më hash, or mik, më dhëmbët e mprehtë,  
a do të të bjerë ndër mend një gjë nuk e di:  
saçmat mua më qëlluan, éshtë më se e vërtetë,  
por disa prej tyre i mëre edhe ti.

## K E Q V E N D O S J E.

Buji, si shef kuadri mjaft kompetent,  
ariun e ngathët e vendosi postier.

Dhe lepurin veshgjatë, pa u menduar fort,  
e vuri të punojë si hamall në port.

Ankesat kuptohet, po vinin si breshër:  
ariu i çonte letrat me një muaj vonesë.

Ndërsa lëpuri mezi hiqej zvarrë në port,  
më të shumtën e kohës qe me raport.

Vërshonin ankesat nga çdo anë:  
— I hiqni, ju lutem, të paaftë janë!

Dhe bleta zukatë dhe tha e menduar:  
— Çështja nuk më duket aq e ngatërruar!

Së paaftësinë që s'e pranon jetë,  
këqvendosja e shton. Kjo është e vërteta!

## UJKU DHE HËNA

Ujku i uritur,  
një natë të ndritur,  
si nuk gjeti gjë mbi tokë,  
drejt qiellit ngriti kokën,  
hëna e ngrënë  
iu duk  
si kockë plot lëng.

Përveshi sbuzët,  
dhëmbët i mprehu.  
Me kujë e bujë,  
drurët rrëqethi.

Shqipja që e pa  
qeshi dhe i tha:  
— Ulëri edhe ca  
me zë më të fortë,  
se mos ndoshta trembet  
dhe bie për tokë.

## **STUDIMI I KRÖKODILIT**

Në brigjet e Nilit,  
diku në Afrikë,  
qe një krokodil,  
që merrej me kritikë.

Në veprën «madhore»  
për lojën në teatër,  
thoshte krokodili  
edhe ca citate:

— Shumëkujt i vjen  
ndoshta dhe çudi:  
unë kur ha qengjin,  
qaj me lebeti.

Mësimet e para  
në skenë e në jetë,  
(hajde ç'profesor!)  
m'i dha papa vetë.

## FRIKË NGA DEBATU

Soba pyet tenxheren:

— Pse rri larg prej meje?

— Ia kam frikën zjarrit,  
se më nxjerr kallajin.

## K R I J I M I

Kur hyn kokrra e rërës,  
kapakëve të midhjes,  
në heshtje ajo qan,  
nis të tkurret dhe të mblidhet.

Lotin e kulluar,  
dhimbjen që e çan,  
e kthen e duruar,  
në margaritar.

## *PROJEKTI DHE KRITIZERËT*

Mes pyllit kalonte një lumë  
i turbullt, pa fre, me valë të egra.  
Që brigjet të lidheshin me urë,  
projektin e bëri bleta.

Për shqyrtimin e projektit,  
u formua një komision me ekspertë  
i përbërë nga shumë anëtarë,  
mes të tjerash:  
elefanti, xhirafa, lepuri dhe gomari.

Elefanti për disa çaste heshti,  
pastaj me feçkë kroi veshin  
dhe tha:

— Dakort jam me gjithçka,  
veç mendoj që këmbët e urës  
të jenë më të mëdha.

Jo sepse nuk më mbajnë mua,  
por duhet parashikuar  
çdo rast i veçantë,  
kur mbi urë të kalojnë  
disa kope me elefantë.



Fjalën e nxori xhirafa:  
(dylbitë i vareshin tek qafa)  
— Parmakët e urës të jenë më të lartë.  
I kam fëmijët shumë të prapë,  
hidhen e lozin  
sikur kanë djallin në bark...

Lepuri:  
— I mbështes parafolësit e mi,  
po kam dhe unë një vërejtje të vockël:  
tek-tuk në urë,  
të mblidhen ca ferra e shqope  
a ndonjë rrënje fiku,  
ku të fshihem në rast rrëziku.

Dëgjoni se ç'tha gomari,  
pasi palli me gjithë zërin:  
— Një gjë s'po mundem ta shkoqis:  
ura është pér së gjati lumit,  
apo pér së gjeri?!

Duke i dëgjuar, bleta,  
thoshte dhe ajo të vetat:  
— Në fakt, këta kritizerë,  
janë nga pak, të tërë... gomerë.

## DREDHIA E RE

Dhelpra vrau mendjen  
për dredhi të re:  
befas tundi këmbët  
dhe u shtri përdhe.

Pulat dhe këndesi  
e vërejtën gjatë.  
S'dilnin nga qymezi  
se u vinin shtatë.

Zemrën gur këndesi,  
bëri më në fund:  
iu avit dhe sqepin  
ia ngjeshi në hundë.

I hipi përsipër,  
i tërhoqi bishtin,  
pranë thirri pulat,  
kur pa që s'lëvizi.



— Ejani, moj shushka,  
ta marrim me vete!  
Bishtin pér qymezin,  
do t'ia bëjmë fshesë!

Por ja, dhelpra shtrembër  
lëvizi një sy  
dhe hopa, në këmbë,  
brofi si stuhi:

— U nxitove, gjel,  
u gabove rëndë,  
pendët do t'i bëj,  
pér të krojtur dhëmbët.

Dredhia e re  
shpesh është mbuluar  
me cipë të vjetër  
pér të të mashtruar.

## *MIU DHE MAGAZINIERI*

Kur e zuri gafil inventari,  
pështyma iu tha qyqarit:  
— Na griu miu, shokù revizor,  
tri kade me djathë e shëllirë,  
(në të gënjej, mbeça qorr!)  
i hëngri dhe i piu...

Miu,  
atje ku ish futur,  
ngriu:  
— Ta kisha ngrënë, — tha , —  
tërë atë djathë,  
s'do isha mi,  
por ka...



## MENDJELEHTEŞIA E MOLLES

Shiu binte litarë-litarë.

Një krimb në baltë

po hiqej zvarrë.

— O mollë e bukur, zemërgjerë,  
lermë të futem nën lëvoren tënde,  
sa të pushojë ky shi i çmëndur! —

Foli krimbi me një zë që të këpuste zemrën.

Mollës i erdhi keq:

— Eja, ngjitu shpejt!

Kur dielli doli të nesërmen,  
e përshëndeti molla:

— Mirëmëngjes!

Si fjete mbrëmë?

— Ç'ka... bëra gjumië me ëndrra,  
por besoj se do ta bëj më të ëmbël  
këto ditë,

kur ta bëj shtëpizën si drithë...

U shkund molla prej inatit:

— Ah! Ç'më hëngre me të pabesë,  
po vetë e kam fajin.

Erdhi vjeshta.

Gjithë pemët e tjera lidhën kokra,  
e shkretë nxinte molla,  
me gjethet e verdha.

## PULA MODERNE

Para è mbrapa,  
kryq e tärthor,  
eci në llucë  
pula «piktore».

Në fund e kënaqur,  
me buzën në gaz,  
ftoi gjithë kafshët,  
ta ndiqnin nga pas.

U sulën të tärë  
të shihnin pikturën,  
arinjtë dhe grerat,  
drurët e gurët.

— Unë, — tha ariu, —  
nuk jam kompetent,  
por them se piktura  
miliona i vlen.


U hodh dhe ujku  
me dhëmbët plot jargë:  
— Sa mirë! Sa bukur!  
Talent i rrallë!

Foli dhe dhelpa  
shtruar e qëtë,  
e ngriti pikturën,  
e çoi tek retë.

Së fundi pápritur,  
zbriti në tokë:  
— Më tepër pëlqehet  
pula, o shokë!

Kakarisi pula,  
(e ç'të bënte më?)  
dhelpa e shpejtë  
u hodh mbi të.

E fshiu për zverku,  
ia nguli dhëmbët  
dhe rrotull picturës  
mbetën veç pendët.



## **SHKËMBI DHE GURIÇKAT**

Me qysqi dhe me vare  
rrokullisën nëpër shpat  
shkëmbin që kish zënë rrugën,  
ndonëse dukej i madh.

Ferra foli, i tha plepit:  
— Shih, po shih se ç'gjullurdi!  
Ç'kusur kanë guralecët  
të rrëshqasin keq mbas tij?

— Mirë t'u bëhet, — i tha plepi,  
bázament kishtë ata...  
Ndaj tanë që rrokulliset  
le t'i vënë rishtas pas!

## **MACJA MBRAPA XHAMIT**

Mbrapa xhamit tē vitrinës nē ushqimore,  
qëndronte një mace e dhjamosur nē qetësi.  
Shikonte me indiferencë përjashta, e plogët,  
bulevardin e zhurmshëm plot gjallëri.

Kishte kohë macja çative pa bredhur,  
kishte kohë macja pa gjuajtur minj,  
aq sa kish filluar tē harrojë tē ecurën,  
aq sa kish filluar tē harrojë tē mjaullijë.

Por çdo gjë e paska nē fund një «por»,  
kështu dhe qetësia e maces mbaroi papritur:  
e zbuau prej xhamit tē vitrinës nē ushqimore  
dhe padashur mbeti mes rrugës e habitur.

E hutuar hodhi sytë rrreth e për qark,  
e shurdhuar nga britmat, zhurmat, boritë,  
saqë nga hutimi nuk vuri re aspak  
një makinë që me shpejtësi i hipit përsipër.

Pranë saj qëndroi disa çaste një maçok i zi,  
e pa me keqardhje dhè bëri një epitaf:  
— Këtu prehet një mace që jetoi në plogështi,  
të fjetur e kish jetën, i zi fundi i saj.

## ZHGËNJIMI I LARASKËS

Një laraskë pendëmurrme  
na pëlqente xhínglat shumë,  
dhe çdo send që kish shkëlqim  
e rrëmbente fluturim.

Kur një natë prej çatisë  
pa në tokë me gëzim,  
diç shkëlqente xixa-xixa,  
vetëtinte si rubin.

U lëshua si shigjetë  
dhe drejt saj e ngjeshi sqepin.


Por klithi e tmerruar  
dhe nga dhimbja mori malin,  
sqep e gjuhë përvëluar:  
ai ishte gacë zjarri.

Qeshi macja me hare:

— Ha, ha, ha, e he, he, he.

Jo çdo gjë që ndrit si ar,  
është, moj, margaritar.





## **PYLL PA DERRA MUND TË KETË**

Për gjah shkuan gjuetarët,  
çiftet supit mbanin varur.

Kur po çanin pyllin radhë,  
një prej tyre tha diçka:

— Do na vejë gjahu mbarë,  
pyll pa derra, jo, nuk ka!

Disa fjalë tha me vete  
derri fshehur nëpër drurë:

— Pyll pa derra mund të ketë,  
derr pa pyll s'do ketë kurrë!

Bile duhet pyll me ferra,  
ku të fshihemi ne derrat.

## R Y S H F E T I

Kur në tokë mbeti,  
krapi qau, thirri:  
— Se ka fajin grepı,  
ma ka fajin krimbi...




## KUR NUK ZGJIDHET ELEMENTI

Pushkë krisi,  
gara nisi.  
Lepuri si shigjeta  
në horizont u zhduk,  
por edhe breshka  
në barin e gjatë  
më s'u duk.

Dihet përfundimi:  
leпури fitimtar  
erdhi i pari  
si çmim duke marrë  
një lakër të bardhë.

Kaloi një orë, kaluan dy,  
breshka s'po shihej me sy.  
Nisën hamendjet nga juria:



— Do ketë rënë patjetër në hall,  
a është përmbysur në kanal.  
Në ndonjë pellg mund të ketë rënë,  
ose ndoshta ka «strapo» në këmbë.

Kur një zë i mpréhtë  
u dëgjua nga bari  
diķu afér startit:

— Do më lini të qetë  
apo ta lë garën?

Ishte breshka jonë  
që kishte bërë metrat e para  
në māratonë.

## **PRETENDIMI I TYMIT**

Ishte ditë plot me diell,  
avull nxirrnin toka, malet.  
Nuk kicħi gjurmë lart nē qiekk,  
veç injë re sa një sandale.

Si sandale prej fēmije,  
diku qoshes e harruar.  
Mbi çatitë e shtëpive  
tymi ngrihej lehtas, shtruar.

Mburrej tymi te çatia:  
— Lum kush mua më pason!  
Po tē matej drejtësia,  
do tē isha etalon...

Dhe oxhaku shqyhet gazit:  
— Seç lë mbas unë e di...  
Ti baba vërtet ke zjarrin,  
po babai ama s'je ti...

Kur të dalë pakëz era  
duken fjalët e mëdha  
dhe del qartë çfarë vlere  
drejtësia jonë ka...

## M U S H K A

Tek mbushte fletanketën,  
në autobiografi  
babanë nuk e përmendi:  
— Kam kalin, — tha, — daji...

## KRITIKË DHE THASHETHEME

Lotët porsi shiu  
i lëshonte gjëmi:  
— Zjarri nuk më nxiu  
por më nxiu tymi.

## VESHËT E MURIT

Tre veta në klub,  
të pirë thumb,  
fjaloseshin «vesh më vesh»:  
— Më tha kunati në konfidencë,  
(ju e dini që nuk flet në erë)  
drejtor në fermë  
bëhet së shpejti një shofer.

Por kjo gjë mos dalë,  
se më merrni në qafë!  
Këto fjalë  
zëreni sikur s'jua thashë.

Dy të tjerët  
menjëherë  
ia pritën me vërtik:  
— Kot mos u lut!  
Cfarë the, or mik,  
i ke hedhur në pus.

Muri që dëgjonte,  
tha:

— C'betim burrëror!  
Sot ky lajm  
përhapet me shpejtësinë  
e reaksionit zinxhir  
termobërthamor.

Dhe pastaj,  
për ironi,  
ua hedhin fajin  
veshëve të mi.

## *ROSA DHE ROSAKU*

Një rosë punonte të bëhej shkrimtare,  
me pendët e bishtit qëndiste skenare.

Një ditë në studio u fut hijerëndë,  
pas saj një rosak po i shkulte një pendë...

Kur doli i thanë: — Ç'martesë e shpejtë!  
Rosaku patjetër yt shoq do të jetë...

— Ky shoku që shihni punon regjisori.  
U bë për skenarin bashkautor.

## **MIU DHE MAÇOKU**

Miu hëngri një libër të vjetër filozofie  
dhe u shtri ta hënepste me nge nën hije.

Maçoku që e ndiqte me vëmendje nga larg,  
iu afrua rrëshqanthi, kobash e tinzar.

Me shpejtësi kërceu mbi miun e dremitur,  
bile dhe bishtin e gjatë duke i kollofitur.

Pas pak filloi të mjaullijë nëpër oborre:  
— Kérkoj edhe unë një gradë shkencore.

## **BRESHKA DHE TRANSFERIMI**

Breshka si breshka, shtyhej ec e ndal,  
puna zinte punën edhe bëhej mal.

Por breshka e kishte lëkurën si dërrasë  
kritikat i priste, duronte pa masë.

Prandaj i qëndisën karakteristikë:  
Organizatore, me stil dinamik!

Qëllimi kuptohet, nuk do shumë mend:  
për ta hequr qafe, në një tjetër vend.

## PËRMBAJTJA

Shqiponja dhë urithi .....	3
Dy trëndafilat .....	4
Korbi dhe fashisti .....	6
Fundi i parazitëve .....	9
Demagogji .....	11
Lëvozhga konservatore .....	12
Mustaqet .....	14
Pleshti me fre .....	16
Sëpatat dhe drurët .....	18
Mburrrja .....	20
Trimëri e rreme .....	22
Para agresionit .....	24
Kneri .....	26
Fund i turpshëm .....	28
Këshillë mikroborgjezi .....	29
Shokët e këqij .....	30
Monologu i fillit .....	32
Përgjegjësia .....	33
Hipur majë gardhit .....	34
Intervista e korbit .....	35
Macja dhe tigri .....	36
Kë qëlluan saçmat .....	37
Keqvendosje .....	38
Ujku dhe hëna .....	39
Studimi i krokodilit .....	40
Frikë nga debati .....	41
Krijimi .....	42
Projekti dhe kritizerët .....	43
Dredhia e re .....	46
Miu dhe magazinieri .....	49
Mendjelehtësia e mollës .....	50

Pula moderne .....	52
Shkëmbi dhe guriçkat .....	55
Macja mbrapa xhamit .....	56
Zhgënji i laraskës .....	58
Pyll pa derra mund të ketë .....	61
Ryshfeti .....	62
Kur nuk zgjidhet elementi .....	63
Pretendimi i tymit .....	65
Mushka .....	67
Kritikë dhe thashetheme .....	68
Veshët e murit .....	69
Rosa dhe rosaku .....	71
Miu dhe maçoku .....	72
Breshka dhe transferimi .....	73